

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse z. Rama mbeti një “çun Tirone” dhe nuk u bë kurrë burrë shteti?
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/pse-z-rama-mbeti-nje-cun-tirone-dhe-nuk-u-be-kurre-burre-shteti-i475382
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:35:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 12:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	92aaaae7e3080f310af9f4c76e97c32b3fe835de36fc1a4d7c15175a5a92da30c
TEKSTI	1d931fa0c60d10ba161f7822ebb574e5b1af8d3ad84a517d2de9ada3e6310410
PAMJA	8a8238b33d539f548eee40830a6b617397b5830e7f210f5065292f76cdbd6c67

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90be8511354cc6b4ba10ff7349b5c046113b242899cf17dfa3805c5b9bc57f5b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90be8511354cc6b4ba10ff7349b5c046113b242899cf17dfa3805c5b9bc57f5b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x


14:27 Aktualitet

Për të tretën herë banorët e Burimasit kanë dalë në protes...

Pse z. Rama mbeti një “çun Tirone” dhe nuk u bë kurrë burrë shteti?



28 Shtator 2026, 14:10, Opinione Dashnor Kokonozi



Sepse, për fat të keq, burrat e shtetit nuk prodhohen në kursin e vizatimit, as në studiot ku mësohet si të bësh poza para kamerës. Aftësia për të mbajtur përgjegjësi është cilësi e rrallë; ndërsa aftësia për t'u fshehur pas shprehjes “unë nuk di asgjë për dardhat pas kurrizit” është zanat i vjetër i “çunave të Tironës” kur vinte fjala për të mbajtur përgjegjësi.

Në fakt, kjo filozofi e “të tjerëve që bëjnë pislëqet” është e denjë për komandantin e një çete pionierësh, jo për kryeministrin e një vendi. Por ja që morali i “çunit” nuk është funksion shtetëror; është thjesht një mënyrë e lehtë për t'i shpëtuar përgjegjësisë. Ndërsa funksioni politik, për fat të keq, nuk të pyet për moralin e lagjes ku je rritur: nxjerr në shesh vetë thelbin tënd.

Dje, temperatura politike ishte aq e lartë sa të gjithë, madje edhe socialistët, prisnin të dëgjonin dorëheqjen e z. Rama. Prisnin ndjesën e tij, ndoshta edhe një grimë reflektim për udhëtimin në New York, ku gjeti guximin të akuzojë popullin e vet para botës. Por jo: lëvozhga e “çunit të Tironës” nuk çahet kaq lehtë. Ai doli dhe tha se nuk mban përgjegjësi për atë që bëjnë të tjerët. Ironia është se këtë e thonë zakonisht ata që nuk kanë asnjë përgjegjësi, jo ata që fluturojnë me avionë e helikopterë për qejf, mbledhin qeverinë nëpër vende ku pushojnë vetë dhe shpenzojnë miliona për gjethe dekorative te dritarja e zyrës.

Pastaj, me një pafajësi që do ta kishin zili edhe aktorët e teatrit amator, bën të paditurin: "Unë nuk dija gjë për dardhat pas kurrizit". Ndërkohë që edhe në Francë na vinin zëra se pas takimit me zëvendësin e tij, te zyra ngjitur, investitorëve u bëhej pyetja e famshme: "Po pjesa ime, cila është?"


Përgjegjësitë? Nga kanabizimi tek inceneratorët, nga sterilizimi te Check-Up-i, nga SHISH-i tek emërimet e turpshme. Thua se ndërkombëtarët të dhanë rekomandime "të shkëlqyera" për znj. Hyseni, por në fakt, me atë emërim si "garip Tirone", deshe t'ia "dhjesësh" Albin Kurtit, sepse Kosova duhej pyetur e para.

Tahirin e emërove vetë, pastaj bëre të paditurin ndërkohë që vendi u kthye në plantacion kanabisi. Zeqinet i thirre vetë, parlamentin e përdore si bunker kundër drejtësisë, një skemë që e përsërite edhe me znj. Balluku.

Dhe prapë guxon të flasësh për "dardhat pas kurrizit".

Juristët kanë të drejtë: përgjegjësia penale është individuale. Por përgjegjësia e zgjedhjes së njerëzve që e renditën Shqipërinë si vendin më të korruptuar në Europë është e z. Rama.

Këtë ai nuk e pranon dot, sepse për fat të keq, z. Rama kurrë nuk u bë burrë shteti, mbeti thjesht një "çun Tirone" me privilegje shtetërore./ CNA



Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

MILIONERË NGA POLITIKA

Kinemaja shqiptare, kjo kufomë pa varr

Rasputin, patronazhizmi seksual

SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit

Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

VLORE MOJ NUR I PUSHTETIT

Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

TRADHËTIA NDAJ SHTETIT

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

Tani i Madh, Topi i Madh

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

Disa sugjerime për konstatim të përbashkët të gjendjes pas Aktgjykimit të 16 shtatorit

Horizonti i Elbasanit

TË RROFTË EMRI...

Orët e Tiranës

Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!


Bojkotoni takimet me politikanët e Shqipërisë që mbajnë peng demokracinë!

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

14:10 Opinione Dashnor Kokonozi

Pse z. Rama mbeti një “çun Tirone” dhe nuk u bë kurrë burrë shteti?

14:06 Opinione Mitro Çela

MILIONERË NGA POLITIKA

11:28 Opinione Ilnisa Agolli

Kinemaja shqiptare, kjo kufomë pa varr

Lifestyle

22:20 Lifestyle

Ekspertët e modës i miratojnë/ Ja 5 ngjyrat e pazakonta në trend për vjeshtën

Kur bëhet fjalë për tendencat klasike të ngjyrave që janë ...

19:00 Lifestyle

Llumi i kafesë me uthull, ja truku praktik për pastrimin e kuzhinës

Një truk praktik dhe ekonomik pastrimi përfshin përdorimin...

17:52 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.